

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Nr. 02-39/27-06

Prishtinë, më 21 dhjetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës,
2. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Jaku Krasniqi** paraqiti shqetësimet e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjetjen e armëve para një dite në komunën e Drenasit. Ne me kohë kemi kërkuar, shtoi ai, se institucionet përgjegjëse duhet të merren me çështjen e sigurisë dhe ta luftojnë krimin e organizuar. Por, ato nuk kanë vepruar. Në krimin e organizuar janë të inkriminuar institucionet që duhet ta luftojnë atë.

Ai kërkoi që çështja e sigurisë të debatohet në seancën e sotme si çështje e ngutshme ku ministri i rendit duhet t'i informon deputetët e Kuvendit për rastin e djeshëm.

**Alush Gshi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se angazhohet për sundim të ligjit dhe të gjithë që bien ndesh me të duhet të përgjigjen për veprat e bëra. Por, e kundërshtoi vlerësimin e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së se në krimin e organizuar të jenë të përfshira institucionet qeveritare.

**Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se i përgëzon MPB, SHPK, KFOR-in dhe të gjitha segmentet tjera legale të sigurisë në aksionin e identifikimit, kapjes dhe parandalimit të veprimeve të paligjshme në ditën e djeshme. Grupi Parlamentar i AAK-së i jep përkrahje drejtësisë dhe rendit dhe i mbështet hetimet e mëtutjeshme. Çdo keqpërdorim dhe dalje jashtë ligjit duhet të dënohet.

**Teutë Sahatçiu**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se gjetja e armëve jashtë organeve kompetente për mbajtjen e tyre është një çështje serioze, që meriton të debatohet. Për këtë arsye ne i përkrahim shqetësimet, që i ngriti Partia Demokratike e Kosovës. Ne mendojmë se nuk duhet të heshtej ky rast, por të analizohet. Të formohet një Komision Hetimor, i cili do ta analizon implikimin eventual të Qeverisë në këtë rast.

Kryeministri **Agim Çeku** tha se i kupton shqetësimet e ngritura nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe ai i ORA-s. Këto shqetësime janë edhe të miat dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës. Unë dua ta përgëzoj Shërbimin Policor të Kosovës për një hap të tillë.

Njerëzit që e kanë bërë këtë akt kriminal janë të arrestuar dhe gjinden para organeve të drejtësisë. Hetimet duhet t'i kryejnë organet e drejtësisë dhe të SHPK-së dhe të mos ngutemi me kualifikime politike.

Qeveria distancohet nga veprimet e tilla dhe absolutisht nuk ka vend në Qeveri për ata njerëz, që janë të inkriminuar në rastet e tilla.

Ministri i Punëve të brendshme, **Fatmit Rexhepi**, tha se kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së që unë ta përgatisë një informatë, që ka të bëjë me rastet që janë në zhvillim e sipër është e arsyeshme. Unë do ta përgatis informatën, në pajtim me përgjegjësitë e mia, në momentin kur ajo bëhet kërkesë zyrtare nga Kuvendi.

Mendoj se nuk qëndrojnë kualifikimet se Qeveria ose anëtarët e saj janë të inkriminuar në krimin e organizuar.

**Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, tha kërkesa e Grupit Parlamentar për një seancë për ta debatuar gjendjen e sigurisë, në të cilën do të raportonte edhe ministri

brendshëm është krejtësisht normale dhe e domosdoshme. Insistojë që sot të marrim vendim dhe ta caktojmë datën se kur duhet të mbahet kjo seancë dhe të kemi një informatë të saktë rreth kësaj. Mendoj se debati për këtë çështje nuk e destabilizon procesin, nëpër të cilin po kalon Kosova, me faktin se ne po reagojmë kundër ngjarjeve negative

Opinione dhe sugjerime lidhur me çështjen që e ngriti shefi i Grupit parlamentar i PDK-së dhanë edhe këta deputetë: **Gjylane Syla, Nexhat Daci, Sabri Hamiti, Hashim Thaçi, Nekibe Kelmendi, Hajredin Kuçi, Emrush Xhemajli, Nazim Jashari dhe Bujar Dugolli**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së që në seancën e radhës të debatohet për çështjen e sigurisë në vend. Rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica;  
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për të debatuar për çështjen e sigurisë në seancën e radhës.

## **1. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës**

**Kryetari** i njoftoi deputetët për procedimin e kërkesës së Grupit parlamentar për Integrim. Kryesia e Kuvendit, pas shqyrtimit të saj, ia ka dërguar Grupit Negociator me kërkesë për ta përgatitur një informatë në bazë të kërkesës së parashtruar.

Grupi Negociator ka marrë qëndrimin lidhur me vendimin e z. Ahtisari për ta shtyrë propozimin për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të cilin e ka publikuar. Prej asaj kohe nuk ka pasur zhvillime të tjera rreth kësaj çështje. Prandaj, nuk ka diçka të re që mund të thuhet, nuk ka pasur zhvillime të më vonshme për të cilat Grupi i Unitetit do t'i informonte deputetët e Kuvendit.

Kuvendi i dha mbështetje Grupit Negociator dhe kërkoi që me përpikëmeri t'i përmbahen Rezolutës së Kuvendit të Kuvendit të Kosovës të 17 nëntorit të vitit 2005.

Kuvendi do ta thërras Grupin e Unitetit për të raportuar para deputetëve në njërën nga seancat e radhës.

## **2. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë**

**Kryetari** e ftoi propozuesin ta arsyetojë kërkesën për të debatuar lidhur me gjendjen energjetike në vend.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se gjendja në energjetikë është tepër e rëndë për të mos thënë se është në kolaps pa shenja përmirësimi, por vetëm përkeqësimi.

Gjatë shtatë viteve disa herë është ndërruar menaxhmenteti i KEK-ut , por asnjë herë nuk ka pasur ndërrime esenciale.

Dështimet janë në politikat programore të menaxhimit, si: mjetet financiare në miniera; në logjistikë; në mihje e miniera; në termoelektrana; në distribucion; në faturim, si dhe në inkasim.

Deri tani me KEK-un ka menaxhuar edhe AKM-ja, me menaxhmente të jashtme këshilltarë të brendshëm, tani KEK-u po drejtohet gjithë politikisht nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave. Ministria në vend që t'i bënte politikat e mbikëqyrjes ajo është përshirë në Bordin udhëheqës dhe e drejton inkasimin. Kështu që dështimi i KEK-ut është edhe i dështim i Qeverisë.

Menaxhimi me miniera ka qenë dhe vazhdon të jetë pika më e dobët në energjetikën e Kosovës. Këtu kanë ndodhur avaritë më të mëdha dhe askush nuk ka dhënë asnjë përgjegjësi as morale, politike dhe as ligjore.

Ne jemi të bindur se pa i ndryshuar politikat, pa i ndalë të gjithë keqpërdoruesit e pasurisë kombëtare, pa i ndalë të gjitha format e vjedhjeve në Korporatën Energjetike të Kosovës gjendja energjetike nuk do të përmirësohet.

Ne jemi të bindur se me një tjetër politikë, me një menaxhim më të mirë të resurseve njerëzore, të mjeteve financiare dhe të resurseve të tjera në Korporatën Energjetike të Kosovës, Kosova do të dilte më shpejtë nga kollapsi energjetikë dhe do të kishte më shumë dritë, më shumë energji për zhvillimin ekonomik të vendit.

Ministri i Energjetikës dhe i Minierave, **Et'hem Çeku**, kërkoi mbështetje nga Kuvendi i Kosovës për tejkalimin e situatës energjetike, që është e rëndë, por jo pa rrugëdalje.

Synimet e MEM-it përqendrohen në realizimin e strategjisë së energjisë, për të cilën kemi përgatitur dhe po e zbatojmë një program tri vjeçar.

Objektivi i përgjithshëm për sektorin energjetik ka qenë dhe mbetet reformimi dhe transformimi i tij, për të krijuar parakushte për investime dhe mbështetur fuqishëm zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të Kosovës.

Për realizimin e këtyre objektivave ministria është e orientuar në këto drejtime kryesore:

Mbështetjen për përmirësimin e situatës së furnizimit me energji elektrike. Ndërmarrja e veprimeve që do të siguron furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike në periudhën afatmesme. Për të përmirësuar situatën të furnizimit me energji elektrike ministria e ka mbështetë KEK-un me kuadër të taskforcës duke përcjellë nga afër dhe duke i koordinuar aktivitetet që lidhen me rrjetin e inkasimit të energjisë së faturuar. Vetëm në nëntor është arritur që të kemi diku 37% të rritjeve të inkasimeve më të mëdha se në vitin paraprak.

Sa i përket nismës për tërheqjen e investimeve të mëdha private në bashkëpunim me Bankën Botërore, Agjensionin Evropian, USAID ka filluar intensivisht puna në mënyrë që brenda vitit 2007, 2008 të kryhen të gjitha hapat e nevojshëm për përzgjedhjen e investitorit privat, që të angazhohet për hapjen e minierës së re në Sibovcë. Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe rehabilitimin e disa blloqeve të Kosovës A.

Një ndër çështjet tjera të rëndësishme të cilët i kemi në trajtimin e sipër janë rastet sociale, për të cilën në vitin 2005 nga buxheti i Konsoliduar i janë ndarë 12,5 milion €. Edhe për vitin 2007 janë ndarë e 4.5 milion €.

Për të zvogëluar nevojën për importimin e energjisë kemi mbështetur konceptin e rehabilitimit të Kosovës A.

Arsyeja pse nuk ka furnizim të rregullt të energjisë elektrike është se gjatë periudhës së okupimit të Serbisë 1990 -1999 shumë objekte të KEK-ut janë shkatërruar tërësisht, janë vjedhur dhe janë plaçkitur. Gjatë asaj periudhe jo vetëm që s'është investua, por është plaçkitur në forma më të egra më të mundshme një kompani e cila në veti tani i ka 7 mijë e diçka punëtorë.

Për periudhën 2000 – 2006 kemi rritjen e konsumit diku mbi 8%, sidomos në amvisëri. Në amvisëri kemi diku rritjen mbi 70% të konsumit. Prodhimi aktual i termocentralit Kosova B, prodhimi vjetor është rreth 3.2 miliardë orë energji. Termocentrali Kosova A, prodhon rreth 1 miliardë, hidrocentralet të cilat janë rinovuar dhe janë në përdorim prodhojnë 0.12 miliardë, dhe për me i plotësua kërkesa që KEK-u të mund të furnizon qytetarët me energji elektrike 5 me 1 duhet të kemi edhe import 0.7 miliardë orë energji elektrike.

Ministria është e gatshme të bënë rishqyrtimin edhe një herë, bashkë me Komisionin Funkcional të Kuvendit, të gjithë atyre politikave, të cilat mendohet se duhen të realizohen. Jemi të gatshëm t'i pranojmë të gjitha ato sugjerime që vinë nga Komisioni Funkcional, nga grupet parlamentare dhe nga deputetët për ta zhvilluar sektorin e energjetikës dhe të vendit në tërësi.

Pastaj kryetari hapi debatin për gjendjen energjetike në vend.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për gjendjen energjetike në vend dhanë edhe këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Mazllom Kumnova, Gjylnaze Sylja, Genc Gorani, Rifat Krasniq, Berat Luzha, Xhevat Bislimi, Selvije Halimi, Gani Koci, Ibush Jonuzi, Xhavit Haliti, Bajram Kosumi, Bajrush Xhemajli, Behxhet Brajshori, Naim Maloku, Teutë Sahatçiu, Zef Morina, Xhelal Canziba, Hatixhe Hoxha, Ali Sadrija, Sala Berisha, Brikenda Kryeziu dhe Nazim Jashari**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Çeku** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Kryesuesi **Sabri Hamiti** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 17:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**